RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Komunikatë

Bordi i RTK-së emëron Adrian Krastën Drejtor të Festivalit të Këngës në RTK edhe për edicionin e dytë

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës (RTK) njofton rreth riemërimit të z. Adrian Krasta, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, në drejtimin e edicionit të dytë të Festivalit të Këngës në RTK. Ky emërim vjen pas suksesit të madh që pati festivali i parë i këngës në RTK nën drejtimin e z. Krastës.

Organizimi i festivalit të parë u karakterizua me shumë sfida dhe vështirësi, por me përvojën, angazhimin dhe drejtimin e drejtorit të festivalit dhe stafit të angazhuar të RTK-së, u bë e mundur që të realizohet ky projekt i madh kulturor, i cili gjeti mbështetje të madhe edhe nga Ministria e Kulturës.

Festivali i vitit të kaluar, i pari i këtij lloji në Kosovë, jo vetëm që magjepsi audiencën, por la gjurmë të pashlyeshme në skenën mbarëkombëtare të muzikës, duke qenë ngjarja më e madhe kulturore në vend. Festivali u dha hapësirë artistëve të rinj që përveç përformimit në festival, këngët e tyre transmetohen edhe në të gjitha kanalet e RTK-së.

Duke u mbështetur në këtë qëllim, organizim dhe përvojë, edicioni i dytë i Festivalit të Këngës në RTK premton të jetë edhe më spektakolar, duke ofruar një platformë për artistët aspirantë që të shfaqin talentin dhe krijimtarinë e tyre në një platformë garuese mbarëkombëtare.

Derisa po vazhdojmë këtë udhëtim emocionues, Bordi i RTK-së rikonfirmon përkushtimin e tij për promovimin e diversitetit kulturor, nxitjen e inovacionit artistik dhe promovimin e sferës muzikore të Kosovës. Ashtu si në edicionin e parë,

Bordi do të jetë mbështetës i fuqishëm dhe do të luajë rol proaktiv në gjithë procesin e punës.

RTK së shpejti do të paraqes aplikimin e saj në EBU që kënga fituese ta përfaqësojë Kosovën në Eurovision Ne jemi optimistë që kënga fituese e Festivalit të dytë me radhë do ta përfaqësojë Kosovën në këtë garë ndërkombëtare. Për këtë çështje është punuar në vazhdimësi nga bordi dhe menaxhmenti i RTK-së dhe është arritur të sigurohet përkrahje nga shumë vende, por në anën tjetër ka edhe pengesa të vazhdueshme për shkaqe politike nga disa vende mosnjohëse të Kosovës.